



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA- QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA- MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVSTVA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. L. No. Prot. Prot. No.	05-2427
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 2 -
Data: Datum: Date:	04 / 04 / 20 24
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara - Office of the General Secretary

Nr: 248/IV/2024

Date: 04.04.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, duke marrë parasysh nenin 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare , Nr. 7,01 Mars 2019), nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative , nxjerr këtë :

VENDIM

- I. Anulohet Vendimi Nr. prot. 05-631 datë 02.02.2024 për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekt/ programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e Promovimit të Shëndetit Mendor dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB.
- II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Me Vendimin Nr. prot. 05-631 datë 02.02.2024, Ministria e Shëndetësisë bën shpalljen publike për projekt/program e të organizatave jo-qeveritare në fushën e Promovimit të Shëndetit Mendor dhe Parandalimit të Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB.

Bazuar në nenin 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ministria e Shëndetësisë sipas detyrës zyrtare e anulon Vendimin Nr. prot. 05-631 datë 02.02.2024, pas njoftimit me datë 28.03.2024 nga Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për mbështetje financiare të OJQ-ve, lidhur me lëshimin teknik në kriteret e shpalljes publike lidhur me licencimin e OJQ-ve për ofrim të shërbimeve shëndetësore që nuk është përfshirë në kriteret e thirrjes publike. Vlerësimi sipas kriterëve aktuale të konkursit mund të rrezikoj që të shkaktoj shkelje ligjore në Ligjin Nr. 04/L-125 për Shëndetësi

Ministria e Shëndetësisë me qëllim të parandalimit të shkeljeve të mundshme ligjore për shkak të lëshimit teknik në kriteret e shpalljes publike e anulon Vendimin Nr. prot. 05-631 datë 02.02.2024, për shpalljen e thirrjes publike për projekt/ program të organizatave jo-qeveritare në fushën e Promovimit të Shëndetit Mendor dhe Parandalimit të Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB .

Njoftimi për Anulimin e Vendimit për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekt/programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e Promovimit të Shëndetit Mendor dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB, publikohet në web faqen e Ministrisë së Shëndetësisë.

Në përputhje me procedurat ligjore, kjo shpallje do të ripublikohet.

Dr. Naim Bardhi
Sekretar i Përgjithshëm



Vendimi i dërgohet:

- *Kabinetit të Ministrit;*
- *Departamenti ZhSSH;*
- *Departamenti Ligjor;*
- *Arkivit të MSh.*